



Prishtinë: 01.03.2013

Kodi i ZRRE-së: V_514_2013

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_891_01_13

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreu IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_891_01_13**; dhe
5. Ankesën e konsumatorit me datë 24.01.2013.

Në mbledhjen e mbajtur më 01 mars 2013, nxorri këtë:

VENDIM

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit E.H (shifra në KEK: DPR - 90064739) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_891_01_13 i datës 09.01.2013.

Arsyetim

Me datë 27.06.2012 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit E.H me shifër DPR 5397, dhe gjatë inspektimit punëtorët e autorizuar kanë konstatuar se shtëpia e konsumatorit është rrënuar. Me po atë datë punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar edhe pikën matëse me shifër DPR – 5580, M.H. dhe gjatë inspektimit punëtorët e autorizuar kanë konstatuar se shtëpia e konsumatorit është rrënuar.

Pas këtij inspektimi Departamenti i Faturimit në KEK përmes urdhër lejimit/ngarkimit nr. 44531 ka bërë transferimin e borxhit nga shifra DPR – 5397 në DPR – 90064739 në vlerë 247.95 €, si dhe përmes urdhër lejimit / ngarkimit nr. 44565 ka bërë transferimin e borxhit nga shifra DPR – 5580 në DPR – 90064739 në vlerë 225.38€.

Pas kësaj ngarkese të bërë nga KEK-u konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për këtë transfero borxhi. Departamenti për Konsumator në KEK pas ankesës së bërë nga konsumatori ka shqyrtuar lëndën e konsumatorit dhe ka refuzuar ankesën e tij. Konsumatori pas marrjes së përgjigjes nga ana e KEK-ut, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me të cilin ka kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 24.01.2013 ka nxjerr vendim duke **refuzuar** ankesën e konsumatorit.

Pas marrjes se vendimit të DMK-së, më datë 06.02.2013 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, me të cilën ka kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_8791_01_13 të datës 24.01.2013. Konsumatori në ankesë thekson se në bazë të ligjit të procedurës civile neni 81, boxhi i taksave të RTK-së së vjetërsuar qysh nga viti 2004 të shlyhet. Në ankesë konsumatori ka theksuar se taksat e RTK-së kanë qenë antikushtetuese dhe antiligjore andaj edhe nuk i ka paguar duke i ndarë nga shpenzimet e rrymës. Konsumatori thekson se gjerë në viti 2004 ka qenë i ngarkuar me një televizor mirëpo për shkak të bllok tarifës ka instaluar edhe një njehsor tjetër dhe më ka



ngarkuar edhe me atë njehsor për RTK. Pra KEK-u taksat e RTK i ka transferuar nga shifrat DPR – 5397 në shifrat DPR – 5380 në shifrën DPR – 90064739, të cilën e konsideron si antiligjore.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 01.03.2013 ka shqyrtuar dhe analizuar dëshmitë e paraqitura nga konsumatori, përkatësisht kundërshtimet e theksuara në ankesë ndaj vendimit të DMK-së.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar procesverbalet e kontrollës së KEK-ut (nr. 1710328 dhe nr. 1710329 të datës 27.06.2012) dhe raportet e inspektimit të KEK-ut dhe është vërejtur se punëtorët e KEK-ut kanë bërë inspektimin e pikave matëse të shifrave DPR – 5397 dhe DPR – 5580 me ç'rast edhe është konstatuar se shtëpia e konsumatorit është rrënuar, kanë evidentuar numrat e njehsorëve elektrik nr. 7478049 dhe nr. 1275156, por që nuk kanë evidentuar shpenzimet e regjistruar në këta njehsor.

ZRRE ka analizuar transferimin e borxhit bërë nga shifrat DPR - 5397 dhe DPR - 5580 në shifrën DPR – 90064739 dhe konstaton se KEK sha ka bërë prerjen e borxhit të krijuara në shifrat DPR - 5397 dhe DPR - 5580 deri në periudhat 06/2010 si dhe ka zbritur pjesën e taksës së papaguar për Radio Televizionin Publik. Sipas transaksioneve konsumatorëve borxhi i përgjithshëm në shifrën DPR - 5397 deri në periudhën 04.07.2010 ka qenë 302.84€, ndërsa në shifrën e konsumatorit DPR - 5580 deri më datë 04.07.2010 ka qenë 267.25€.

Sipas nenit 20.4 të Ligjit Nr. 02/L-47 për Radiotelevizionin e Kosovës të gjitha subjektet fizike dhe juridike në territorin e Kosovës janë të obliguar të paguajnë parapagimin për transmetuesin publik. Si një subjekt i tillë do të konsiderohen njësitë të cilat kanë një faturë për rrymë apo ndonjë faturë tjetër publike. Ndërsa sipas nenit 20.3 dhe 20.9 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës të liruar nga obligimi i cekur me lartë, përfshihen banorët e vendbanimeve ose pjesët e vendbanimeve të Kosovës ku mungon sinjali cilësor televiziv i rrjetit tokësor, dhe Familjet që janë përfshirë në listën e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale si kategori e veçantë përfshirë edhe ato që janë nën asistencë sociale.

Duhet theksuar se me datë 16 tetor 2009 Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë një Vendim Akti Nr. MP-01/09, ku ka marrë një masë të përkohshme lidhur me zbatimin e mëtejme të nenit 20.1 të Ligjit mbi Radio Televizionin e Kosovës dhe i ka rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës që të ta rishikoj natyrën e nenit 20.1 dhe praktikën e bazuar në të.

Bordi i ZRRE-së pas analizimit të gjitha proceseve të KEK-ut, dhe ankesës së konsumatorit konstaton se Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka vepruar drejt në vendimin e tij.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 01.03.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. **ZRRE/DMK_V_891_01_13**, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar